



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

Nr. 1070 prot.

Tiranë, më 20.1.2020

Lënda: Dërgohet Udhëzimi plotësues “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”.

MINISTRIA/ INSTITUCIONI _____

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT

DEGA E THESARIT _____

Mbështetur në ligjin nr. 88/2019 “Për Buxhetin e vitit 2020” dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, bashkëlidhur ju përcjellim Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 20.01.2020, “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”.



MINISTËR

Anila Denaj



UDHËZIM PLOTËSUES

Nr. 2 datë 20.01.2020

“PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2020”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 21, të ligjit 88/2019, “Për Buxhetin e vitit 2020” dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, paragrafi 2.

UDHËZOJ:

I. Procedura specifike shtesë për zbatimin e Buxhetit të Shtetit

Të Përgjithshme

1. Për çdo njësi shpenzuese të krijuar, çelet kodi përkatës në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), pas paraqitjes së kërkesës zyrtare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, e shoqëruar detyrimisht me aktin përkatës ligjor ose nënligjor, apo akte të tjera administrative të krijimit të saj. E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastin e mbylljes së një njësie shpenzuese.
2. Për çdo njësi arkëtuese jo shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme dhe për çdo njësi arkëtuese jo buxhetore (për shembull njësitë me vetëfinancim, etj.), çelet kodi përkatës në SIFQ në zbatim të aktit përkatës ligjor ose nënligjor, apo akte të tjera administrative të krijimit të saj.
3. Njësitë shpenzuese gjatë përdorimit të fondeve buxhetore të planifikuara për “Mallra e Shërbime”, me prioritet urdhërojnë pagesat për shërbimet e furnizimit me energji elektrike (në kushtet e mungesës së likuiditetit dhe/ose planit të arkës, respektohet renditja në pikën 151 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”). Strukturat përgjegjëse për

Thesarin në degë, verifikojnë listën e debitorëve të dërguar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) çdo muaj dhe autorizojnë pagesën e faturave të tjera, vetëm nëse njësia shpenzuese nuk rezulton me detyrime të papaguara në këtë listë. Në rast të kundërshtimeve, njësia shpenzuese rakordon me OSHEE dhe vetëm pas sqarimit zyrtar të detyrimit vijojnë pagesat e tjera. Në rast se detyrimi është objekt i një çështjeje gjyqësore, njësia shpenzuese duhet të paraqesë një dokument që vërteton se çështja është në proces gjyqësor. Këto përcaktime janë të vlefshme edhe në rastin kur institucionet përfitojnë fonde buxhetore në formën e subvencioneve.

4. Dëmshpërblimi i nëpunësve civilë që për shkak të ristrukturimit lirohen nga shërbimi civil do të paguhet nga artikulli 606 (Transferta tek individët), pas rialokimeve të fondeve nga artikujt e tjerë të shpenzimeve korrente.
5. Letër Krediti i qeverisjes së përgjithshme (LC) është instrument pagese i kërkuar në kushte specifike të zbatimit të buxhetit nga njësitë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme. Ky instrument pagese, aplikohet duke transferuar paratë nga llogaria e unifikuar e Thesarit “Depozitë e Qeverisë” në bankën e nivelit të dytë, në një llogari bankare të çelur me emërtimin e projektit të kontraktuar në pronësi të njësisë shpenzuese deri në momentin e lëvrimin të mallit/shërbimit.
6. Zbatimi i vendimeve gjyqësore që lidhen me procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, si dhe rikthimi i vlerave të arkëtuara subjekteve që u është ndërprerë procesi i legalizimit në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin e integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, do të përballohen me të ardhurat e realizuara nga transferimi i parcelës ndërtimore, të cilat nuk janë transferuar në llogarinë e kompensimit të pronave.
7. Në zbatim të pikës 1 dhe 2 të nenit 9, të ligjit nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të dixhital-dividentit”, procedura e transferimit pjesor të arkëtimeve që krijohen nga pagesat në vlerën e arritur në procesin e konkurrimit për frekuencat e brezit te caktuar, përshkruhet si më poshtë:
 - a) Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP-i) rakordon me degën e Thesarit Tiranë për arkëtimet që krijohen nga pagesat në vlerën e arritur në procesin e konkurrimit, sipas procedurës së përcaktuar në nenet 68 dhe 69, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për frekuencat e brezit te caktuar, të cilat derdhen në Buxhetin e Shtetit nga fituesit e të drejtave të përdorimit të tyre dhe njofton Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA-n) duke i percjellë një kopje të akt-rakordimit të mbajtur me degën e Thesarit Tiranë.

- b) AMA në bazë të njoftimit nga AKEP-i mbi të ardhurat e krijuara, kërkon zyrtarisht në Aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë transferimin e një pjese të tyre, duke i bashkëlidhur kërkesës, kopjen e aktrakordimit sipas pikës 1 me sipër.
- c) Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, mbas marrjes në dorëzim të kërkesës nga protokoll, përgatit kërkesën për rritjen e autorizuar për përdorimin e të ardhurave të arkëtuara nga fituesit e të drejtave të përdorimit të frekuencave të brezit të caktuar. Nëpunësi zbatues dhe autorizues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, miratojnë urdhër shpenzimit me përshkrimin “Transfertë për ekzekutimin e kompensimit financiar nga AMA për kalimin nga transmetimet analoge në transmetimet numerike sipas pikës 2, të nenit 9, të ligjit 34/2017”.
- d) Për realizimin e pikës c) më sipër, bazuar në kërkesën Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, struktura e thesarit në degë bën rritjen e autorizuar për përdorimin e të ardhurave për institucionin e AKEP-it në kapitullin 06. Më pas, Aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë paraqet kërkesën për transferim fondi në strukturën e thesarit në qendër, e cila kryen transferimin e planit të thesarit, nga institucioni i AKEP –it tek institucioni i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i cili, në përfundim, kryen transfertën e shumës respektive me urdhër shpenzim në favor të AMA-s.
8. Procedura e kthimit të vlerave të llogaritura gabimisht më tepër gjatë procesit të rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK-ja), i cili operon si agjent tatimor (grupi 80) për arketimin në buxhetin e shtetit (në emër të zyrave vendore të ASHK pranë bankave të nivelit të dytë, në llogarinë bankare të të ardhurave të thesarit) të pagesave për tatimin nga rivlerësimi i pasurive të paluajtshme përshkruhet si më poshtë:
- Pas rakordimit me Degën e Thesarit për shumën e evidentuarë që duhet t’i kthehen individëve, zyra vendore e ASHK do të paraqesë urdhër shpenzimit së bashku me dokumentat justifikues pranë degës së thesarit respektive për kthimin e shumës tek individit/personi juridik përfitues i kësaj shume. Për këtë qëllim, cdo ZVASHK duhet të miratojë në strukturën përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nëpunësin e saj autorizues dhe atë zbatues për nënshkrimin e urdhër shpenzimit si dhe të bëjë depozitimin e firmave të autorizuarë në degën e thesarit.

Detajimi i fondeve buxhetore

9. Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit të Buxhetit nr. 88/2019 “Për Buxhetin e vitit 2020”, nëpunësi i parë autorizues informon me shkrim nëpunësit autorizues të çdo njësie të qeverisjes qendrore për shpërndarjen e fondeve buxhetore sipas klasifikimit buxhetor për vitet 2020-2022. Struktura përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, regjistron në SIFQ fondet buxhetore në nivel agregat dhe në nivel produkti për vitet 2020 – 2022.

10. Pas organizimit të procesit të detajimit, nëpunësit autorizues të njësisë të qeverisjes qendrore dërgojnë pranë nëpunësit të parë autorizues, zyrtarisht dhe në formë elektronike detajimin e fondeve buxhetore për vitet 2020-2022 sipas strukturës buxhetore për të gjitha njësitë shpenzuese dhe sipas formatit të përcaktuar në shtojcën nr. 1 “Formati i detajimit të fondeve buxhetore”. Pasi miratohet nga Nëpunësi i Parë Autorizues, detajimi i buxhetit dërgohet zyrtarisht tek çdo njësi e qeverisjes qendrore dhe bëhet i vlefshëm për zbatim vetëm pasi rregjistrohet në sistemin informatik financiar të qeverisë nga struktura përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë përgjegjëse për Financat apo në Njësinë e Qeverisjes Qendrore, përkatësisht sipas të drejtës që ato kanë për përdorimin e sistemit informatik financiar të qeverisë.
11. Procedura të veçanta zbatohen për detajimin e fondeve buxhetore të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit si më poshtë:
- a. Fondet e buxhetit për arsimin e lartë.
- a.1 Fondet e buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë shpërndahen në formën e grantit. Ky fond shpërndahet sipas kategorive; i) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë; ii) granti i mësimdhënies; iii) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese. Modeli i financimit për institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.2.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor” Kriteret për përdorimin e granteve të politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë dhe granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese, janë përcaktuar në nenin 111 dhe nenin 113 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Zbatimi i skemës së financimit, për institucionet publike të arsimit të lartë, kryhet sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për arsimin nr. 20, datë 20.09.2019, “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”.
- a.2 Mbartja e fondit të grantit të arsimit të lartë të papërdorur gjatë vitit 2019, do të bëhet sipas procedurës si më poshtë:
- Të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë rakordojnë me Degët e Thesarit lidhur me fondet e papërdorura gjatë vitit 2019 për grantin e arsimit të lartë përkatësisht në strukturat:
 - Grupi 11, Programi 09450, Kapitulli 08, Artikujt 600, 601, 602, 604, 605, 606.
 - Grupi 11, Programi 09770, Kapitulli 08, Artikujt 600, 601, 602, 604, 605 dhe 606.
 - Një kopje e këtij akt-rakordimi paraqitet zyrtarisht nga Institucionet e Arsimit të Lartë pranë nëpunësit të parë autorizues, për tu mbartur në të njëjtën strukturë buxhetore në vitin pasardhës.

- b. Fondet për Qendrën Kombëtare të Bisnesit (QKB) janë të planifikuara si transferta në planin e Ministrisë përgjegjëse për ekonominë. Fondet e QKB-së të Bashkive, pas detajimit sipas klasifikimit buxhetor ekonomik, paraqiten për rishpërndarje tek nëpunësi i parë autorizues, në strukturën përgjegjëse për buxhetin, e cila e regjistron në sistemin informatik financiar të qeverisë.
- c. Fondi i planifikuar për shërbimin spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë, në artikullin 604, detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave. Në zbatim të VKM-së, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FDSKSH) paraqet tek Nëpunësi i Parë Autorizues, detajimin sipas strukturave buxhetore të miratuara. Fondet për spitalet bëhen të disponueshme në Kapitullin 08 (Burimi i fondit buxhetor).

12. Për Fondet Speciale:

- a. Një kopje e buxhetit vjetor e miratuar nga Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit.
 - b. Një kopje e buxhetit vjetor e miratuar nga Këshilli Administrativ i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit.
13. Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), në detajimin e planit të miratuar të investimeve për programin buxhetor për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale në buxhetin e vitit 2020, me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve.
14. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të FSHZH-së, në përputhje me ecurinë e projektit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit mund të kërkojë rialokime midis projekteve, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.
15. Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimin e projekteve të reja kryhen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.
16. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2020 miraton shpërndarjen e fondeve për financimin e projekteve të reja investimi për grantin për arsimin.
17. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në buxhetin e vitit 2020 me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në vazhdim, të financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë mund të kërkojë rialokime midis projekteve të FZHR-së, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

18. Detajimi i fondeve për investime të miratuara në ligjin nr. 882019, "Për Buxhetin e vitit 2020", si dhe kërkesat për rishpërndarje apo për fonde shtesë për investime, do të paraqiten për miratim pranë ministrit përgjegjës për financat.
19. Njësitë e qeverisjes qendrore, në detajimin e planeve të miratuara të investimeve, do të mbajnë parasysh këto kritere dhe përparësi në financimin e projekteve:
- a. Projektet e investimeve të propozuara për financim duhet të jenë pjesë e projekteve të propozuara dhe të shqyrtuara nga Këshilli i Ministrave dhe të paraqitura në Kuvend, për vitin 2019;
 - b. Projektet në vazhdim nga viti 2019 ose më parë, do të financohen me përparësi dhe duhet të jenë pjesë e prioriteteve të propozuara për financim gjatë vitit 2020.
 - c. Detyrimet për TVSh-në, Taksa Doganore ose bashkëfinancimet nga buxheti i shtetit për projektet me financim të huaj, do të financohen në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet financiare të projekteve dhe në përputhje me vlerën e financimit të huaj të planifikuar për vitin 2020. Financimi i projekteve me financim të huaj nuk duhet të tejkalojë tavanin e miratuar në ligjin e buxhetit për vitin 2020.
 - d. Gjatë shqyrtimit dhe miratimit të detajimit fillestar për projektet e financuara me fonde IPA si edhe të kostove respektive të bashkëfinancimit dhe TVSH-së, do të mbahen parasysh procedurat e përcaktuara në udhëzimin nr.10 datë.9.03.2015 "Për përcaktimin e procedurave për menaxhimin nëpërmjet Fondit Kombëtar të Bashkëfinancimit të buxhetit të shtetit për projektet IPA", të ndryshuar.
 - e. Projektet e reja të propozuara për financim duhet të kenë kaluar procedurat e miratimit në kuadër të PBA-së 2019-2021 si dhe bazohen në kriteret e përcaktuara në VKM nr.185, datë 29.03.2018 "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike" dhe Aneksin I bashkangjitur ketij vendimi.
 - f. Për angazhimet buxhetore shumëvjeçare, që lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë vitit të parë të zbatimit të tyre, në buxhetin e njësisë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme të shpërndahen jo më pak se 20 për qind e vlerës së plotë të projektit përkatës.
 - g. Nëse projekti i propozuar nuk ka qenë pjesë e PBA-së 2020-2022 dhe nëse nuk plotëson asnjë nga kushtet e mësipërme, kërkesa për financim duhet të paraqitet vetëm në kuadër të rishikimit të buxhetit vjetor.
 - h. Shtesat në planin e miratuar të projekteve të investimeve publike në kuadër të kontratave për punime shtesë ose të ndryshimeve në planin e projekteve, si dhe rialokimet e fondeve ndërmjet projekteve gjatë zbatimit të buxhetit, do të bëhen me miratim paraprak të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, bazuar në relacionin dhe argumentet mbi domosdoshmërinë e tyre.
20. Fondet për projektet e reja të investimeve për blerjen e pajisjeve elektronike/informatike dhe sisteme IT, që lidhen me Teknologjinë e Informacionit, bëhen efektive pas lidhjes së kontratës nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

21. Në zbatim të VKM nr. 673, date 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, AKSHI është institucioni i vetëm përgjegjës për kryerjen e procedurave të prokurimit, tenderimit dhe lidhjes së kontratës për të gjitha sistemet e Teknologjisë së Informacionit (TI). Për këtë qëllim, procedura që do të ndiqet është si vijon:
- Lidhja e të gjitha kontratave për blerjen e mallrave dhe shërbimet për mirëmbajtjen e sistemeve TI (shpenzime kapitale dhe korente), kryhet nga AKSHI.
 - Për shpenzimet korrente dhe kapitale kontrata lidhet në emër të titullarit të AKSHI-t, me përfitues të mallit dhe/ose shërbimit, AKSH-in, pasi fondet përkatëse për vitin 2020 për mirëmbajtjen e sistemeve të IT të njërive të qeverisjes qendrore si dhe fondet e investimeve për përmirësimin e sistemeve të IT, kushteve të AKSH-it dhe për Sistemet Qeveritare, janë të miratuara në buxhetin e AKSH-it. Këto kontrata depozitohen nga ana e AKSH-it në degën e thesarit për t’u regjistruar në SIFQ.
 - Në tabelën 2 bashkëlidhur janë përcaktuar shpenzimet kapitale për sistemet IT të njërive të qeverisjes qendrore, të cilat janë të planifikuara në buxhetin e AKSH-it.
22. Plani i miratuar në ligjin e buxhetit për financimet e huaja, është kufiri i cili duhet të respektohet gjatë procesit të kryerjes së shpenzimeve, si për projektet me skeme të plotë thesari ashtu edhe për ato me skemë të pjesshme thesari (jashtë TSA, në bankat e nivelit të dytë, kodit 00). Në rast tejkalimi të planit të shpenzimeve, njësitë e qeverisjes qendrore do të marrin masa për sistemimin e tyre nëpërmjet rialokimeve gjatë vitit dhe gjatë procesit të rishikimit të buxhetit.
23. Në rastet kur në marrëveshjen dypalëshe, të nënshkruar për zbatimin e projekteve me financim të huaj, është përcaktuar që disbursimi nga donatori/kreditori do të bëhet pasi të jetë kryer shpenzimi dhe pasi të jetë vlerësuar performanca e projektit, atëherë për kryerjen e shpenzimit, ministritë/institucionet, në rast se nuk kanë parashikuar fondet përkatëse në planin e buxhetit vjetor, do të shqyrtojnë mundësinë e një rialokimi për të siguruar fondet e nevojshme.
24. Fondet e rimbursuara nga donatori/kreditori, sipas projekteve përkatëse, derdhen në buxhetin e shtetit dhe regjistrohen në një zë të veçantë për t’u dalluar nga grantet dhe kreditë e tjera, me emërtimin “Rimbursim i shpenzimeve, pas vlerësimit të performancës”.
25. Për institucionet e arsimit të lartë, që kanë përdorur të ardhurat e veta për financimin e projektit/eve, fondi i rimbursuar nga donatori/kreditori pas vlerësimit të performancës së projektit/eve në fjalë, i kalon institucionit përkatës të arsimit të lartë që ka kryer shpenzimin nga të ardhurat e veta, në masën e shpenzimit të kryer, dhe perdoret prej tij si e ardhur.”
26. Për njësitë e vetëqeverisjes vendore, që kanë përdorur të ardhurat e veta për financimin e projektit/eve, fondi i rimbursuar nga donatori/kreditori pas vlerësimit të performancës së projektit/eve në fjalë, i kalon njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore që ka kryer shpenzimin nga të ardhurat e veta, në masën e shpenzimit të kryer, dhe perdoret prej saj si e ardhur.

27. Fondi i Rindërtimit do të përdoret për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019. Mënyra e përdorimit të Fondit të Rindërtimit, programet buxhetore ku do të alokohet fondi si dhe institucionet dhe agjencitë, zbatuese të tij, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara trashëgoohen në vitin pasardhës dhe do të përdoren për të njëjtin qëllim.
28. Nëse gjendja e llogarisë sintetike 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” për nënllogarinë analitike 4865100 “Shpenzime të periudhave të ardhshme - detyrime që rrjedhin nga prioriteti i emergjencave” (në të cilën janë regjistruar urdhër shpenzimet e datuara në vitin 2019 që në zbatim të pikës 3 të urdhrit të ministrit përgjegjës për financat nr. 21920, datë 02.12.2019 “Mbi prioritetin e pagesave në kushtet e gjendjes së shpallur të fatkeqësisë natyrore”, i ndryshuar, nuk përfshihen në prioritetet e pagesave), rezulton me vlerë të ndryshme nga zero pasi në vijim të vendimarrjes së Komitetit të Menaxhimit të Buxhetit janë urdhëruar të mos paguhen kundrejt fondeve buxhetore të vitit 2019, atëherë struktura përgjegjëse për thesarin në degë të regjistrojë këto urdhër shpenzime menjëherë me celjen e fondeve të vitit 2020 në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ) duke njoftuar njësinë e qeverisjes së përgjithshme me qëllim procesimin e pagesës elektronike kundrejt gjendjes së mbartur të llogarisë së unifikuar të Thesarit “Depozitë e qeverisë” në Bankën e Shqipërisë.

Rishpërndarja e fondeve buxhetore

29. Kufiri i shpenzimeve, sipas tabelës I, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020” mund të rishpërndahet gjatë vitit ndërmjet programeve brenda të njëjtit institucion buxhetor apo ndërmjet programeve të institucioneve të ndryshme nga Këshilli i Ministrave deri në masën 10 për qind të shumës së përgjithshme të shpenzimeve korrente apo shpenzimeve të përgjithshme kapitale, duke ruajtur totalin e shpenzimeve korrente dhe kapitale. Për vitin 2020, zbatimi i buxhetit do të bëhet nëpërmjet Sistemit Informatik të Qeverisë (AGFIS) si pjesë e Sistemit Informatik të Menaxhimit Financiar (AFMIS), në përputhje me dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022. Për rrjedhojë, rishpërndarjet e fondeve buxhetore sipas përcaktimeve të nenit 44, të ligjit nr. 9936/2008 i ndryshuar, do të ekzekutohen edhe në nivel produkti sipas formatit të përcaktuar në shtojcën nr. 2 “Formati i rishpërndarjes të fondeve buxhetore”.
30. Çdo rishpërndarje e fondeve, shtesë e fondeve mbi buxhetin e miratuar vjetor si edhe çdo rishikim i buxhetit në përputhje me përcaktimet e neneve 44, 45 dhe 46 të ligjit nr. 9936/2008, i ndryshuar, mund të ndryshojë ose jo sasinë e produkteve respektive të lidhura me to. Përditësimi i sasisë së produkteve pra shtesa apo pakësimi e sasisë së produkteve duhet të kryhet nga njësia e qeverisjes qendrore rast pas rasti në sistemin AFMIS.

31. Krijimi i një produkti të ri gjatë vitit buxhetor (për shkak të përfitimit të një fondi buxhetor mbi tavanet e miratuara për njësinë e qeverisjes qendrore në tabelën 1 të ligjit vjetor të buxhetit si psh përfitimi nga Fondi Rezervë), bëhet nga njësia e qeverisjes qendrore në sistemin AFMIS pas aprovimit të ministrisë përgjegjëse për financat. Fondet e alokuara me aktet ligjore/nënligjore për produktin e ri sipas kodit përkatës të tij bëhen efektive në sistemin informatik financiar të qeverisë në përputhje me strukturën buxhetore përkatëse.
32. Për shpenzimet kapitale, krijimi i një projekti të ri investimi ose produkti të ri në një projekt ekzistues investimi, (për shkak të përfitimit të një fondi buxhetor mbi tavanet e miratuara për njësinë e qeverisjes qendrore në tabelën 1 të ligjit vjetor të buxhetit si psh përfitimi nga Fondi Rezervë) do të kryhet në modulën e menaxhimit të investimeve publike, nga njësia e qeverisjes qendrore pas aprovimit të ministrisë përgjegjëse për Financat. Fondet e alokuara me aktet ligjore/nënligjore për projektin e ri/produktin e ri bëhen efektive në sistemin informatik financiar të qeverisë në strukturën buxhetore përkatëse.
33. Rishpërndarjet e fondeve midis shpenzimeve korrente dhe projekteve/produkteve të investimeve publike për vitin 2020 duhet të analizohen nga njësia e qeverisjes qendrore nëse prekin parashikimet e bëra për vitet 2021 dhe 2022. Në rast se po, këto ndryshime duhet të reflektohen në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe në sistemin AFMIS për periudhën 2021-2022.

Kontrolle financiare paraprake shtesë, në procesin e menaxhimit të fondeve publike

34. Me qëllim menaxhimit financiar eficient të fondeve publike dhe parandalimit e krijimit të detyrimeve të papaguara në kohë, në nenin 11 të ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”. janë miratuar tavanet buxhetore për çdo program, të ndara për shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale për vitet 2020-2022.
35. Kontrolli mbi limitet e angazhimit do të realizohet duke ndjekur procedurën si më poshtë:
- Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme depoziton regjistrin e prokurimeve publike zyrtarisht dhe elektronikisht në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe Degën e Thesarit në fillim të çdo viti buxhetor, si dhe çdo ndryshim të tij gjatë vitit, përpara fillimit të procedurës së prokurimit. Në çdo rast, shuma totale e prokurimeve vjetore duhet të jetë e barabartë ose më e vogël se fondet e miratuara vjetore.
 - Në rast se parashikohen prokurime për kontrata shumëvjeçare, ato duhet të paraqiten në regjistrin duke specifikuar veçmas fondin e nevojshëm për vitin buxhetor 2020 dhe fondet e parashikuara për secilin vit buxhetor, deri në plotësimin e shërbimeve/punimeve të planifikuara.
 - Dega e Thesarit kryen kontrollin e totalit të fondeve të paraqitura në regjistrin e prokurimeve me totalin e fondeve të miratuara në buxhetin e njësisë dhe, vetëm pasi vulozet nga Thesari urdhri i prokurimit, njësia mund të fillojë procesin e prokurimit në Agjencinë e Prokurimeve Publike.

- Institucionet buxhetore, të cilat operojnë direkt në SIFQ, regjistrojnë në sistem çdo vlerë prokurimi të përcaktuar në planin e miratuar të prokurimeve të institucionit dhe pasi marrin numrin unik të regjistrimit në SIFQ dhe vulën e Thesarit, procedojnë me dërgimin në Agjencinë e Prokurimeve Publike.
- Të gjithë urdhrat e prokurimit që nxirren gjatë vitit për mallrat, shërbimet dhe investimet duhet të paraqiten në degën e Thesarit, së bashku me ftesën për prokurim, të cilat duhet: (i) t'i përmbahen listës së prokurimeve të dorëzuar në Thesar, (ii) të kontrollohen për përputhshmëri me regjistrin e prokurimeve dhe të vulosen nga dega e Thesarit, përpara procedimit, sipas rregullave të prokurimit publik.
- Nëse në degën e Thesarit paraqitet një urdhër prokurimi i pambuluar me fonde buxhetore, atëherë dega e Thesarit refuzon me shkrim dokumentin e paraqitur dhe për këtë njofton Agjencinë e Prokurimit Publik. Në asnjë rast, Agjencia e Prokurimit Publik nuk fillon procedurën zyrtare të prokurimit, pa pasur më parë një miratim të degës përkatëse të Thesarit.

36. Për të siguruar kontrollin që angazhimet shumëvjeçare të jenë brenda tavanëve trevjeçare të fondeve, të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit, ndiqet kjo procedurë:

- a. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme që operojnë online në SIFQ, regjistrojnë dhe mbartin direkt në të, të gjitha kontratat e tyre, vjetore apo shumëvjeçare të reja apo në vazhdim, sipas vlerave përkatëse për çdo vit të buxhetit të miratuar trevjeçar;
- b. Për njësitë e qeverisjes së përgjithshme që nuk operojnë online në SIFQ, regjistrimi dhe mbartja e kontratave, vjetore apo shumëvjeçare, bëhet nga dega e thesarit përkatëse, sipas vlerave të përcaktuara për çdo vit të buxhetit të miratuar trevjeçar;
- c. Në të dyja rastet e përcaktuara në pikat a) dhe b) mësipër, nëse kohëzgjatja e kontratës shumëvjeçare shkon përtej periudhës trevjeçare të ligjit të miratuar të buxhetit, pjesa e mbetur e vlerës së kontratës, pas regjistrimit të vlerave për çdo vit të buxhetit të miratuar trevjeçar, regjistrohet në vitin buxhetor pasardhës që vjen menjëherë pas vitit të fundit të ligjit të miratuar të buxhetit trevjeçar.
- d. Përjashtim nga procedura e mësipërme përbën regjistrimi në SIFQ i angazhimeve të shpenzimeve korrente për spitalet, pasi referuar nenit 5 të ligjit nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave. Për vitin 2020, hedhja në sistemin informatik financiar të qeverisë të kontratave për shërbimin spitalor do të bëhet pas miratimit të detajimit të fondit përkatës për shërbimin spitalor për vitin 2020. Në rastin e kontratave shumëvjeçare, në sistemin informatik financiar të qeverisë do të hidhet vetëm shuma përkatëse e kontratës për vitin 2020.

37. Kontratat e lidhura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të paraqiten dhe të procedohen në degën e Thesarit përkatës sipas kërkesave të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit. Në rast vonese, dega e Thesarit procedon me regjistrimin në SIFQ dhe njofton menjëherë Nëpunësin e Parë Autorizues, i cili ndërmer masa administrative ose inspektim financiar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për paraqitjen me vonesë në degën e Thesarit të dokumenteve që vërtetojnë shpenzimin e kryer”.

38. Në rastin e kontratave shumëvjeçare, njësia shpenzuese nuk duhet të pranojë faturimin nga operatori ekonomik, për kryerjen e shërbimit apo ofrimin të mallrave objekt të kontratës, brenda vitit financiar në një vlerë më të madhe sesa buxheti i miratuar për atë kontratë në vitin financiar respektiv. Në raste të domosdoshmërisë së lëvrimin të shërbimit/mallrave para kohës së përcaktuar në kontratë, atëherë njësia shpenzuese duhet më parë të sigurojë miratimin e shtesës së planit të buxhetit dhe më pas të ndryshojë kushtet e kontratës për kohën e lëvrimin të shërbimit/mallrave`.

Numri i punonjësve buxhetorë dhe shpenzimet e personelit

39. Numri maksimal i punonjësve për çdo ministri dhe institucion qendror detajohet nga ministrinë dhe institucionet qendrore në përputhje me emërtesën e institucionit dhe numrin përkatës të saj të përcaktuar në Urdhrin e miratimit të strukturës së çdo institucioni varësie brenda numrit total të njësisë së qeverisjes qendrore të përcaktuar në tabelën nr. 2 të ligjit vjetor. Si rregull, ky numër i shtrën efektet financiare duke filluar nga data 1 Shkurt 2020, ndërsa në muajin Janar për pagesat e punonjësve do të operohet me numrin e punonjësve të muajit Dhjetor të vitit 2019.
40. Në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 88/2019 “Për Buxhetin e vitit 2020”, për vitin 2020 nuk do të miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësive të qeverisjes qendrore me efekte financiare shtesë në koston e personelit. Këtij rregulli i nënshtrohen edhe ato struktura në të cilat paga për funksion jepet ose është sipas gradës përkatëse, ku çdo rritje në gradë do të bëhet efektive vetëm nëse nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në koston e përllogaritur, sipas gradave të miratuara. Përrjashtim bëjnë institucionet e reja të krijuara gjatë vitit.
41. Efektet financiare të ndryshimit të strukturave të njësive të qeverisjes qendrore vlerësohen nga struktura përgjegjëse për planifikimin e buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
42. Numri rezervë i punonjësve përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit dhe alokohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Procedurat e detajimit dhe të miratimit përcaktohen në të njëjtën mënyrë si për punonjësit në organikë.
43. Punonjësit me kontratë të përkohshme pune dhe praktikantët e punësuar sipas Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore dhe Institucionet e tjera Publike, mbi numrin organik të miratuar për njësitë shpenzuese, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Për vitin 2020 detajimi i numrit të praktikantëve në institucionet buxhetore të kontraktuar sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 395, datë 29.04.2015 “Për miratimin e programit Kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, të ndryshuar, duhet të paraqitet për miratim pranë nëpunësit të parë autorizues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

44. Efektet financiare për punonjësit e kontraktuar përballohen nga shpenzimet korente të miratuara në buxhetin e vitit 2020, të njësive të qeverisjes qendrore dhe regjistrohen në të njëjtën mënyrë si shpenzimet e personelit organik. Efektet financiare për punonjësit e kontraktuar për Shtëpinë e Pushimit Durrës (të MPB), Shtëpinë e Pushimit të Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH) dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, përballohen nga të ardhurat e vetë institucionit. Për punonjësit e kontraktuar për Qendrat e Formimit Profesional dhe institucionet e varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, efektet financiare përballohen pjesërisht nga të ardhurat dhe pjesërisht nga fondet buxhetore të miratuara për vitin 2020.
45. Çdo ndryshim i numrit të punonjësve nga një njësi shpenzuese tek tjetra, shoqërohet me aktin përkatës të strukturës së miratuar të njësive shpenzuese.
46. Nga rregulli i pikës 45 përjashtohen:
- Institucioni i Prokurorisë së Përgjithshme dhe i Gjykatave, për transferimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve nga një njësi shpenzuese në një tjetër. Miratimi i ndryshimit të numrit të punonjësve organik bëhet pas vlerësimit të koston financiare nga struktura përgjegjëse për buxhetin dhe pas paraqitjes së kërkesës së institucionit të shoqëruar me urdhrin përkatës të emërimit të prokurorit/gjyqtarit.
47. Transferimi i numrit të punonjësve mësimorë organik, nga një shkollë në tjetrën, bëhet pas vlerësimit të koston financiare nga struktura përgjegjëse për buxhetin e institucionit perkates dhe pas paraqitjes së kërkesës së institucionit qendror.
48. Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore përdoret nga çdo njësi shpenzuese për numrin faktik mujor të punonjësve në organikë, brenda numrit limit të miratuar. Nuk lejohet përdorimi i fondit të lirë që rezulton nga strukturat e paplotësuara apo nga reduktimi i strukturave aktuale. Vetëm në raste specifike, përdorimi i këtij fondi miratohet nga Ministria Financave dhe Ekonomisë. Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore përdoret për pagesën e punonjësve me kontratë të përkohshme pune, kur është parashikuar një fond i tillë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
49. Në zbatimin e fondit limit të pagave të mbahen në konsideratë rregullat e përcaktuara në udhëzimin nr. 4, datë 13.12.2016 “Për formën, elementët dhe plotësimin e borderosë së pagave për njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike (DAP) në linkun [ëëë/dap.gov.al](http://dap.gov.al) –*legjislacioni/udhëzim/manuale*.

Fondi i Veçantë

50. Fondi i veçantë i njësive të qeverisjes qendrore nuk është pjesë e fondit të pagave.
51. Nëpunësi i parë autorizues njofton nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qendrore mbi shpërndarjen në nivel njësie të qeverisjes qendrore të një pjese të fondit të veçantë, të miratuar sipas nenit 12 të ligjit nr.88/2019, për t’u përdorur për vitin 2020, sipas tabelës 1 bashkëlidhur këtij

udhëzimi, bazuar në ecurinë faktike të këtij zëri për vitin 2019. Brenda 10 ditëve të miratimit të këtij udhëzimi, nga ana e njësive të qeverisjes qendrore ky fond detajohet në nivel njësie shpenzuese sipas strukturës përkatëse buxhetore në artikullin 606 dhe paraqitet për miratim pranë nëpunësit të parë autorizues. Pasi miratohet ky fond bëhet efektiv në sistemin informatik financiar të qeverisë nga struktura përgjegjëse për buxhetin.

52. Në fondet e shpërndara sipas pikës 51, nuk përfshihen fondet për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për Fondin e Sigurimeve Shoqërore, Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, Universitetet, Qendrën Kombëtare të Biznesit për Bashkitë. Për këto institucione, kërkesa për përdorim nga fondi i veçantë me destinacion të përcaktuar në shkresë, paraqitet nga njësia shpenzuese në degën e Thesarit, duke respektuar kriteret e VKM-së nr.929 datë 17.11.2010, i ndryshuar. Në rast të përdorimit, ai transferohet nga vetë njësitë nga artikulli 600 në artikujt 602 dhe 606, sipas natyrës së shpenzimit. Një kopje e kësaj kërkesë paraqitet nga dega e Thesarit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit për t'u regjistruar në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë me përjashtim të njësive të vetëqeverisjes vendore të cilat e paraqesin kërkesën vetëm në degën përkatëse të thesarit për të bërë të mundur regjistrimin në SIFQ.
53. Përdorimi i fondit të detajuar sipas përcaktimit në pikën 51, do të bëhet nga njësitë shpenzuese të qeverisjes qendrore në përputhje me kriteret e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 929 datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e Fondit të veçantë", i ndryshuar". për përballimin vetëm të shpenzimeve për ndihma të menjëhershme (Art 606). Kërkesa për shpenzim së bashku me dokumentacionin përkatës paraqitet në degën e thesarit përkatës.
54. Përjashtim nga pika 51, bëjnë përdorimet e fondit të veçantë nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe SHISH, për ndihma të menjëhershme dhe shpërblime të akorduara sipas ligjeve të veçanta për raste specifike. Për këto raste, këto institucione i paraqesin kërkesat e tyre për miratim pranë nëpunësit të parë autorizues, si në rastin e përdorimit të fondeve ekzistuese të miratuara ashtu edhe në rastin kur kërkohet akordim fondi shtesë. Fondet shtesë pas miratimit, bëhen efektive në sistemin informatik financiar të qeverisë nga struktura përgjegjëse për buxhetin. Kërkesa për shpenzim së bashku me dokumentacionin përkatës paraqitet në degën e thesarit përkatës.
55. Fondi i akorduar sipas pikës 51, mund të rialokohet nga njësitë e qeverisjes qendrore brenda të njejtit program midis institucioneve. Kërkesa për rialokim të këtij fondi midis programeve paraqitet për miratim pranë nëpunësit të parë autorizues.
56. Kërkesat për fonde shtesë mbi fondin e akorduar sipas pikës 51, për përdorim të fondit të veçantë për ndihma të menjëhershme, shpërblime dhe aktivitete sipas përcaktimeve në VKM nr. 929, datë 17.11.2010, njësitë e qeverisjes qendrore e paraqesin për miratim pranë nëpunësit të parë autorizues.

57. Fondi i shpërndarë sipas tabelës 1 bashkëlidhur mund të rishpërndahet midis njësive të qeverisjes qendrore nga ana e nëpunësit të parë autorizues.
58. Përdorimet e fondit të vecantë nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme do të rregjistrohen në artikujt 600, 602, 606 sipas natyrës së shpenzimit përkatësisht për shperblime, për zhvillimin e aktiviteteve dhe ndihma të menjëhershme.

Menaxhimi i likuiditetit

59. Njësia e qeverisjes së përgjithshme paraqet urdhër-shpenzimin, duke përcaktuar qartë datën e pagesës së faturës sipas kontratës.
60. Në SIFQ regjistrohet data e faturës së furnitorit, data e urdhër-shpenzimit të përgatitur dhe paraqitur në Thesar nga njësia e qeverisjes së përgjithshme, data e regjistrimit të urdhër-shpenzimit në SIFQ, si dhe data në të cilën duhet të kryhet pagesa për faturën respektive, e cila duhet të jetë në përputhje me kushtet e kontratës. Ky rregull zbatohet edhe nga institucionet buxhetore që kanë akses të drejtpërdrejt në SIFQ.
61. Niveli (“buffer”) i gjendjes monetare të llogarisë së unifikuar të Thesarit “Depozitë e Qeverisë” përcaktohet si mesatarja mujore e shpenzimeve të planifikuara dhe të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit për zërat: shpenzime korente të personelit, si dhe shpenzime sociale për ndihmën ekonomike dhe papunësinë (pagesat e shërbimit të borxhit mbulohen me emetimet e ankandeve të letrave me vlerë të qeverisjes qendrore), që përbën kufirin maksimal në fillim të çdo muaji. Kufiri minimal përcaktohet në bazë të të dhënave të parashikimit të flukseve monetare hyrëse dhe dalëse të llogarisë së unifikuar të Thesarit “Depozitë e Qeverisë” (versionit pesimist të Thesarit) në masën e mesatares së parashikimit të tre ditëve (rreth tre miliardë lekë) të pikut të muajit të mëparshëm.
62. Për sa përcaktuar më sipër niveli i “buffer” mund të jetë fleksibël gjatë zbatimit në përshtatje me kushtet aktuale.

Transaksionet në valutë të huaj

63. Gjatë procesit të menaxhimit të shpenzimeve të projekteve me financim të huaj, që administrohen me skemë të pjesshme Thesari, transfertat nga llogaritë speciale në Bankën e Shqipërisë në llogaritë bankare të projekteve me financim të huaj, kryhen në monedhën shqiptare nga struktura qendrore përgjegjëse për Thesarin, përveç kontratave të lidhura në valutë të huaj dhe të shprehura në nenin e veçantë të kontratës për mënyrën e pagesës, sipas paragrafit 151 të udhëzimit të ministrit përgjegjës për financat nr.9 datë 20.03.2018.

Llogaritë speciale

64. Transferta nga qeverisja qendrore për fondet speciale e miratuar në buxhetin vjetor 2020, do të bëhet duke marrë parasysh gjëndjen e llogarisë bankare të mbartur nga viti i mëparshëm sipas procedurës si më poshtë:

- Transferta për fondet speciale e miratuar në buxhetin vjetor 2020, do të çelet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet degës së thesarit tek njësia publike respektive (Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm për Kujdesin Shëndetësor dhe Agjensia e Trajtimit të Pronave) kundrejt paraqitjes nga ana e saj të ekstraktit më të fundit të llogarisë bankare (në Bankën e Shqipërisë dhe në bankat e nivelit të dytë).
- Përgjegjësi i degës, pasi analizon argumentet e paraqitura për gjëndjen e llogarive nga strukturat përgjegjëse për fondet speciale, urdhëron kryerjen e plotë apo të pjesshme të transfertës nga llogaria e unifikuar e thesarit “Depozitë e qeverisë”. Nëse gjendja e llogarisë bankare është më e lartë se sa nevojat për transfertë nga buxheti, dega e thesarit nuk miraton kryerjen e saj. Çdo mosmarrëveshje zgjidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Llogaria speciale e ish të përndjekurve politikë

65. Nëpunësi autorizues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përdor fondet e planifikuara për të përndjekurit politikë në grupin 13, në masën dhe sipas listë-pagesave të miratuara nga Nëpunësi i Parë Autorizues.

66. Në vijim të Udhëzimit nr. 5 dt.15/04/2016 “Procedurat e përlllogaritjes së përfitimeve nga ligjet e mëparshme dhe të pagesave të dëmshpërblimit për ish të dënuarit politik të regjimit komunist”, shtojmë sqarimin si më poshtë:

- Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë harton listë-pagesën dhe mbi bazën e tyre përpilon përmbledhësen për çdo bankë. Përmbledhësja totale e pagesave, e detajuar për çdo bankë të nivelit të dytë, i dërgohet Nëpunësit Autorizues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për procedimin e pagesës në llogaritë e bankave të nivelit të dytë, nëpërmjet strukturës përgjegjëse të Thesarit në degë.

67. Në prioritetet e pagesave sipas pikës 151 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, Për procedurat standarte të udhëzimit të buxhetit”, të konsiderohet prioritet “transaksioni i pagesës për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve”, në renditje direkt pas pagesës “ndihmë ekonomike”.

68. Çdo pagese e procesuar në bankat e nivelit të dytë që rezultojnë me instruksione të gabuara bankare të kthehet brenda 24 orëve për t’u riprocesuar pas korrigjimit të gabimit.

Llogaria speciale e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë

69. Llogaria “Fondi i Shpronësimeve” në Bankën e Shqipërisë përbëhet nga:

- a. Gjendja e trashëguar nga vitet e kaluara e papërdorur, por e angazhuar tërësisht me vendime të Këshillit të Ministrave, që ka mbetur në llogarinë e unifikuar të Thesarit “Depozitë e Qeverisë” në Bankën e Shqipërisë, e cila do të përdoret me paraqitjen e listës së përfutuesve në zbatim të VKM-ve të miratuara. Strukturat përgjegjëse të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme duhet të saktësojnë listat përpara tre viteve të mëparshme dhe të raportojnë zyrtarisht (me protokoll dhe në format elektronik) gjendjen e saktësuar në strukturën përgjegjëse për Thesarin në Ministrinë e Financave.
- b. Shuma e papërdorur deri më datën 31 Dhjetor të vitit 2019 dhe e paangazhuar me Vendime të Këshillit të Ministrave do të përdoret në vitin 2020 e vazhdim, për shpronësime në proces apo shpronësime të reja sipas VKM-ve të miratuara.

Llogari të veçanta në bankat e nivelit të dytë

70. Bazuar në fondet buxhetore në dispozicion, nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes së përgjithshme urdhërojnë kryerjen e shpenzimeve në zbatim të udhëzimit për mbylljen e llogarive vjetore të ministrit përgjegjës për financat, përveç rasteve specifike të mëposhtme:
- a. Ekzistenca e dokumentacionit që provon shpenzimin e ndodhur (fatura e furnitorit) nuk mund të shoqërohet me marrjen në dorëzim të mallit/shërbimit brenda afatit të caktuar në paragrafin e mësipërm për kushte specifike të prodhimit të mallit (si furnizimet strategjike: armatime, helikopterë, rezonanca magnetike, etj.) apo kryerjes së shërbimit (mirëmbajtjes së objekteve të rëndësishme strategjike, etj.)
 - b. Përdorimi i mallit apo kryerja e shërbimit ndikon në mosfunksionimin normal të njësisë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme dhe është i pamundur planifikimi për vitin e ardhshëm buxhetor.
71. Për rastet e përmendura në pikën e mësipërme lejohet përdorimi i formës së pagesës me Letër Krediti (LC) sipas përcaktimeve të nënshkruara në kontratën me operatorët ekonomikë në bazë të urdhrave të ministrit përgjegjës për financat, në zbatim të pikës 160 të Udhëzimit të Përhershëm nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.
72. Struktura përgjegjëse për Thesarin në degë, pranon njohjen dhe regjistrimin në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë të shpenzimeve për llogari të vitit 2019, që konstatohen në zbatim të pikës së mësipërme. Regjistrimi i faturave duhet të përfundojë dhe të kryhet rakordimi përfundimtar me institucionin, sipas afatit të caktuar në udhëzimin e mbylljes së llogarive vjetore. Pagesa kryhet nga llogaria e unifikuar e Thesarit “Depozitë e Qeverisë” në një llogari të veçantë të çelur në bankën e nivelit të dytë me emërtimin e projektit të kontratës, sipas përcaktimeve të nënshkruara me operatorin ekonomik. Gjendja në fund të vitit 2019 e llogarive të veçanta bankare në pronësi të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme që krijohen nga përdorimi i formës së pagesës me Letër Krediti si më sipër, raportohet në të dhënat e treguesve fiskale të konsoliduar të qeverisjes së përgjithshme në zërin “Të tjera” të burimeve të brendshme të financimit.

73. Në vijim të VKM nr. 740, datë 12.12.2018 “Për caktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (bonus) për nënat me foshnjë të porsalidura dhe procedurën e dhënies së tij” transfertat nga llogaria e unifikuar e Thesarit “Depozitë e qeverisë” në Bankën e Shqipërisë në llogarinë bankare të veçantë “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - Bonus për nënat me foshnja të porsalidura” në bankën e nivelit të dytë do të kryhet kundrejt paraqitjes nga struktura përgjegjëse e institucionit të ekstraktit të fundit bankar në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë.
74. Përgjegjësi i degës së Thesarit, pas argumentimit të pamjafueshmërisë së gjendjes së llogarisë bankare të veçantë nga strukturat përgjegjëse e institucionit, autorizon kryerjen e plotë apo të pjesshme të transfertës. Nëse gjendja e llogarisë bankare është më e lartë se sa nevojat për transfertë, struktura përgjegjëse për Thesarin në degë nuk autorizon kryerjen e saj.”

Të ardhurat jashtë limitit

75. Në të ardhurat jashtë limitit, të cilat mbarten në vitin buxhetor pasardhës, përveç përcaktimit në Udhëzimin e “Procedurave standarde të zbatimit të buxhetit”, përfshihen edhe të hyrat e mëposhtme:
- a. Të hyrat që mblidhen nga Zyrat e Përmbarimit për llogari të të tretëve;
 - b. Të ardhurat që institucionet sportive arkëtojnë nga pjesa që u takon me ligj nga loto sportive ose nga sponsorizimet e tjera;
 - c. Fondet e akorduara nga Kompania Energjetike Shqiptare për përballimin e dëmeve nga përmbytjet;
 - d. Të ardhurat nga organizmat e vlerësimit të konformitetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, që përdoren për pagesën e vlerësuesve të kontraktuar nga kjo drejtori në zbatim të ligjit nr. 9824 datë 01.11.2007 “Për akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, VKM -së nr. 1716, datë 03.10.2008 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit” dhe standardit S SH ISO 17011:2005 që rregullon veprimtarinë e organizmave akreditues;
 - e. Të ardhurat e realizuara nga procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje “Për transferimin e parcelës ndërtimore”, sipas akt-rakordimit midis Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe strukturave përgjegjëse për Thesarin në degë, të cilat nuk janë transferuar në llogarinë speciale të fondit të kompensimit të pronave, pranë Bankës së Shqipërisë;
 - f. Të ardhurat nga Parku Kombëtar i Butrintit;
 - g. Të ardhurat nga pagesat e kryera nga deklaruesit për shërbimin e kryerjes së analizave laboratorike për verifikime doganore, në zbatim të marrëveshjes së asistencës ndërmjet Agjencisë së Doganave Italiane, Inspektoratit Qendror Teknik, Institutit të Ndërtimit, Universitetit të Tiranës, Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan dhe Strukturës Përgjegjëse për Doganat Shqiptare në fushën e laboratorëve kimikë doganorë;
 - h. Të ardhurat e realizuara nga shitja e mallrave rezervë shtetërore gjatë procesit të freskimit të mallrave rezervë dhe që përdoren për zëvendësimin e mallrave të shitura;

- i. Të ardhurat gjendje të mbledhura nga arkëtimi i detyrimeve nga furnizimi me karburant pa akcizë për mekanikën bujqësore, serat me ngrohje dhe subjektet, që kanë kaldaja në linjat e përpunimit të qumështit, të cilat trajtohen sipas VKM-së nr. 438, datë 20.05.2015 “Për krijimin e fondit Kombëtar të garancisë për kreditimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural”;
- j. Të ardhurat nga shoqëritë e sigurimit për pagesat që do të kryhen për rastet e dëmtimit të mjeteve të siguruara;
- k. Të ardhurat nga shoqëritë e sigurimit për pagesat që do të kryhen për rastet e dëmtimit të godinave të siguruara. Të gjitha të ardhurat e këtij lloji të realizuara në vitin 2019 do të mbarten në vitin 2020.
- l. Të ardhurat e realizuara nga pagesat e kryera nga operatori ekonomik për mbulimin e shpenzimeve për punonjësit e rekrutuar në mbështetje të kontratës specifike të nënshkruar midis tyre dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në zbatim të VKM-së nr. 143, datë 13.02.2013. “Për disa shtesa në Vendimin nr. 205, datë 13.04.1999 të Këshillit të Ministrave, ‘Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor’”;
- m. Të ardhurat e realizuara nga fondet e transferuara nga ana e partive politike për llogari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të cilat përdoren për kryerjen e pagesave të ekspertëve kontabël të licencuar në zbatim të ligjit nr. 10374, datë 10.02.2011 “Për partitë politike”, të ndryshuar;
- n. Të ardhurat e institucioneve, të realizuara nga fondet e akorduara nga “Fondi i Posaçëm për Parandalimin e Kriminalitetit dhe Edukimit Ligjor”;
- o. Të ardhurat si mjete në ruajtje, të realizuara nga shitja e objekteve nën administrimin e Ndërmarrjeve, në zbatim të VKM-së nr. 418 datë 09.07.1998, të ndryshuar;
- p. Të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e realizuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë;
- q. Të ardhurat e përftuara nga kontributet e detyrueshme që nga krijimi i “Fondit të çështjeve të mira”, si edhe të ardhurat e institucioneve buxhetore të realizuara nga fondet e akorduara nga “Fondi i çështjeve të mira”, në zbatim të VKM-së nr.192, datë 04.03.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për përzgjedhjen e projekteve, organizatave apo eventeve nga ‘Bordi i çështjeve të mira të Lotarisë Kombëtare’”;
- r. Të ardhurat e Ministrisë përgjegjëse për Energjinë që sigurohen nga zbatimi i VKM-së nr. 522 datë 30.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga shpronësimi për qëllim ndërtimi, pronësisë, shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe transferimit në favor të shtetit, të projektit të një hidrocentrali të ri në Ashtë, në qarkun e Shkodrës”; të ndryshuar”.
- s. Të ardhurat e Ministrisë përgjegjëse për Energjinë që sigurohen në zbatim të pikës 4, nenit 27. të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ndryshuar me ligjin nr. 10073. datë 09.02.2009 “Për një shtesë në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” në të cilin thuhet: *“Detyrimi për taksën i takon investitorit. E ardhura nga taksat, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast për llogari të bashkisë ose të komunës, që mbulon territorin ku bëhet investimi”*.

- t. Fondet buxhetore të kthyer nga partitë politike pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, të cilat do të rishpërndahen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bazë të Vendimit të KQZ, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
- u. Të ardhurat nga përdorimi i të drejtës së autorit në zbatim të ligjit 35/2016 ‘Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.
- v. Arkëtimet e kontributeve vullnetare të kontabilizuara në llogarinë ekonomike 7207013 – “Donacione për emergjencat dhe fatkeqësi natyrore” çelur në planin kontabël posaçërisht për gjendjen e shpallur të fatkeqësisë natyrore dhe emergjencës nga Këshilli i Ministrave trashëgohen në vitin 2020 dhe perdoren ne vijim;
- w. Të ardhurat që i mbeten në përdorim Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave në zbatim të pikës I.b të Udhëzimit të përbashkët “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”.
76. Në të ardhurat jashtë limitit që nuk mbarten në vitin buxhetor pasardhës, përveç përcaktimit në Udhëzimin nr.9 datë20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, përfshihen edhe të ardhurat e mëposhtme:
- Të ardhura nga shitja e dokumentacionit tatimor, pullave fiskale dhe biletave të transportit rrugor;
 - Të ardhurat nga shtëpitë e pushimit të Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ Shtetëror, si dhe të ardhurat nga shërbimi i transportit të mjeteve të bllokuara (karro-atreci) dhe të ardhurat nga parkimi”;
 - Të ardhurat deri në 10 milionë lekë, që siguron çdo vit Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë nga shërbime metrologjie, në zbatim të VKM-së nr.571 datë 29.08.2012;
 - Të ardhurat e gjykatave që krijohen nga tarifa gjyqësore sipas përcaktimeve të ligjit nr. 98/2017 “Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”.
 - Të ardhurat e realizuara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) në zbatim të ligjit nr.9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. të ndryshuar; VKM-së nr.860 datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” dhe ligjit nr.10186 datë 05.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar, që përbëhen nga:
 - *Të ardhurat e arkëtuara nga pagesa e tarifës së shërbimit për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik, si dhe çdo penalitet tjetër që shoqëron procesin e legalizimit;*
 - *Nga 30 për qind e fondit të të ardhurave të arkëtuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë së parcelës ndërtimore informale, si dhe nga 20 për qind i fondit të të ardhurave të arkëtuara nga kalimi i të drejtës së pronësisë së truallit në zonat e stimuluar të turizmit, pasi të derdhet në Buxhetin e Shtetit shuma prej 170.000.000 lekë.*
- Këto të ardhura do të përdoren nga ASHK-ja për përballimin e shpenzimeve të evidentimit në terren dhe të hartimit të dokumentacionit për ndërtimet pa leje, si dhe të efekteve financiare për punonjësit me kontratë të përkohshme.

- f. Të ardhurat e Ministrisë së Mbrojtjes që do të sigurohen nga shitja e armëve, teknikës, pajisjeve, municioneve dhe lëndëve eksplozive të Forcave të Armatosura për përdorim ushtarak/ jo për përdorim ushtarak/për çmontim e çmilitarizim, shitja e pjesëve të këmbimit të teknikës dhe pajisjeve, shitja e materialeve që përfitohen nga asgjësimi e shkatërrimi i armëve, teknikës, pajisjeve, municioneve dhe lëndëve eksplozive, sipas VKM nr.463 datë 09.07.2014;
- g. Të ardhurat që siguron Ministria e Financave dhe Ekonomisë nga kontratat e qirasë të lidhura nga ndërmarrjet dhe shoqëritë shtetërore me kapital 100 për qind shtetëror, të cilat i përdor në zbatim të VKM nr.54 datë 05.02.2014 “Për mbulimin e shpenzimeve të shoqërive me kapital 100 për qind, që rezultojnë me vështirësi financiare, si edhe për pagesën e ekspertëve që hartojnë vlerësimin e investimeve të kryera nga qiramarrësit për kontratat e qirasë ose të enfi-teozës të lidhura për pasuri ku sipërfaqja e truallit është mbi 500 m²”;
- h. Shuma deri në 2% e të ardhurave tatimore të mbledhura, bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 9920. datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM nr.991 datë 09.12.2015, të cilat përdoren nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- i. Të ardhurat nga shërbimi pyjor në zbatim të ligjit nr.9385 datë 04.05.2005, i ndryshuar.
- j. Të ardhurat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që sigurohen nga marrëveshja ndërmjet Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe shoqërisë së huaj “SPIECAPAG-Shqipëri”, për ofrimin e shërbimeve që kanë lidhje me eskortimin e mjeteve jashtë norme dhe të veçanta, gjatë të gjithë periudhës së ndërtimit të gazsjellësit TAP në territorin shqiptar, deri në përfundimin e projektit “Gazsjellës TAP”.

II. Kritere dhe procedura specifike shtesë për zbatimin e buxhetit vendor

77. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashki dhe qarqe). çelet në strukturën: Ministria e Linjës 00, Program 04960, Kapitull 01, e ndarë në katër 3 mujorë. si vijon:

- a. Për bashkitë dhe qarqet në tremujorin e parë 30%, të dytin 25%, të tretin 23% dhe të katërtin 22%.

Kur njësia e vetëqeverisjes vendore kërkon avancim të limitit tremujor të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme, duhet t'i drejtojë zyrtarisht Nëpunësit të Parë Autorizues një kërkesë të argumentuar për avancim fondi. Nëpunësi i Parë Autorizues pas marrjes së kërkesës nga njësia e vetëqeverisjes vendore vlerëson kërkesën dhe vendos për avancimin ose jo të fondeve.

78. Transferta e pakushtëzuar sektoriale për njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë), çelet në strukturën: Ministria e Linjës 00, Program xxxxx, Kapitull 01, e ndarë në katër tre-mujorë, si vijon:
- a. Për bashkitë në tremujorin e parë 30 %, të dytin 25%, të tretin 23% dhe të katërtin 22%.
79. Fondet e papërdorura të transfertës së pakushtëzuar të trashëguar nga viti 2019, të rregjistrohen në Kapitullin 01, për t'iu shtuar fondeve të transfertës nga qeverisja qendrore për vitin 2020.
80. Fondet e papërdorura të transfertës së pakushtëzuar sektoriale sipas funksioneve, të trashëguara nga viti 2019, të rregjistrohen në Kapitullin 01, për t'iu shtuar fondeve të transfertës nga qeverisja qendrore për vitin 2020. Këto fonde do të përdoren për të rritur cilësinë e shërbimit në këto sektorë.
81. Sipas aneksit 4 të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, në transfertën e bashkive: Berat, Cërrik, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Gramsh, Has, Kavajë, Kolonjë, Korçë, Kukës, Lezhë, Lushnjë, Malësi e Madhe, Mat, Mirëditë, Përmet, Pukë, Sarandë, Shkodër, Skrapar, Tepelenë, Tiranë, Vau i Dejës, Vlorë, janë të përfshira edhe fondet për paga, sigurime shoqërore për personelin e konvikteve të arsimit parauniversitar, shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime.
82. Sipas aneksit 4, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, në transfertën e bashkive: Berat, Elbasan, Kuçovë, Kukës, Fier, Shkodër dhe Vau i Dejës, janë të përfshira edhe fondet për paga dhe sigurime shoqërore për personelin e shërbimit dhe shpenzimet operative për qendrat: “Lira”, Berat, “Balash”, Elbasan, “Besa” Vau i Dejës, “Horizont”, Fier “Opera Della Madonnina Della Grappa”. Shkodër dhe qendrat ditore të fëmijëve me aftësi të kufizuara për bashkitë: Kuçovë, Kukës dhe Shkodër.
83. Sipas aneksit 4 të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, në transfertën e pakushtëzuar sektoriale të bashkisë Tiranë, janë përfshirë edhe fondet për paga dhe sigurime shoqërore për personelin dhe shpenzimet operative të klubeve sportive shumësportëshe “Partizani” dhe “Studenti”.
84. Njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilave i janë shtuar fondet për personelin mësimor në arsimin parashkollor, si pjesë e reformës së sistemit të financimit të arsimit parashkollor duhet të marrin masat për rishikimin e metodës së ndarjes së fondeve për njësitë e arsimit parashkollor në territorin e tyre, duke përdorur si kriter kryesor numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte. Fondet e shtuara për personelin mësimor të arsimit parashkollor në këto bashki përdoren vetëm për shtimin e numrit të edukatoreve.
85. Sipas aneksit 4, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, në transfertën e pakushtëzuar sektoriale të bashkive janë të përfshira:
- Fondet për paga dhe sigurime shoqërore për personelin arsimor në arsimin parashkollor;

- Fondet për paga dhe sigurime shoqërore për shërbimet mbështetëse në arsimin bazë (parashkollori dhe Qendrat Kulturore) dhe të personelit të shërbimeve mbështetëse për arsimin e mesëm;
- Fondet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri;
- Fondet për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative për funksionin e administrimit të pyjeve. Në këtë zë janë të përfshira edhe fondet për paga dhe sigurime shoqërore për rojet e pyjeve;
- Fondet për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative për ujitjen dhe kullimin. Në këtë zë janë të përfshira edhe fondet për paga, sigurime shoqërore për drejtuesit e eskavatorëve, si dhe shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për eskavatorët;
- Fondet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime për rrugët rurale.

86. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore rishikon dhe përgatit buxhetin përfundimtar për miratim në Këshillin e saj. Buxheti i miratuar nga Këshilli, dërgohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në rrugë elektronike dhe me shkresë zyrtare, sipas procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

87. Në vijim të përcaktimeve në Udhëzimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” (pjesa e buxhetit vendor), procedura plotësuese për vitin 2020, janë si vijon:

- a. Për funksionet e deleguara, “Shpenzimet për mbrojtjen sociale”. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për vitin 2020, detajon fondet e mbrojtjes sociale në mënyrë periodike, për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, si dhe në mënyrë specifike për ndihmën ekonomike dhe për pagesën e paaftësisë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të respektojnë destinacionin e përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Fondet e mbrojtjes sociale delegohen si transfertë e kushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në detajimin e fondeve të mbrojtjes sociale, në mënyrë periodike, do të vlerësojë nevojat e njësive të vetëqeverisjes vendore, duke mbajtur parasysh gjendjen e varfërisë, të cilat vlerësohen bashkërisht, duke dhënë pesha specifike të qarta, objektive, transparente dhe mbi bazë kriteresh të përcaktuara;
- b. Fondet e ndihmës ekonomike dhe të paaftësisë që shpërndahen në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe kriteret e parimet e përdorura për shpërndarjen e tyre bëhen publike për të gjitha bashkitë;
- c. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale brenda buxhetit të miratuar të vitit 2020, mund të bashkëfinancojë ose të financojë qendra sociale në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

88. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe fondi për programin për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale do të shpërndahet në bazë të kriterëve dhe procedurave të parashikuara në aneksin nr. 3. të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”.

89. Në bazë të nenit 15 ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, personeli administrativ i Këshillit të Qarkut nuk mund të jetë më shumë se 10 veta. Në personelin administrativ bëjnë pjesë punonjësit jo të zgjedhur.
90. Gjatë zbatimit të buxhetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk mund të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të transfertave të pakushtëzuara sektoriale ose t’i kalojnë nga njëri funksion te tjetri. Këto fonde do të përdoren sipas destinacionit të përcaktuar në tabelën nr.3 të ligjit të buxhetit të vitit 2020. Fondet e trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale përdoren për rritjen e cilësisë së shërbimit të funksioneve përkatëse. Fondet e veta (transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta), bashkë mund t’i përdorin për përmirësimin apo rritjen e cilësisë së funksioneve të cilat financohen me transfertë të pakushtëzuar sektoriale.
91. Njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë përfituar fonde shtesë për personelin mësimor si pjesë e reformës në sistemin e financimit të arsimit parashkollor, duhet të paraqesin një evidencë mbi ecurinë e përdorimit të fondeve për shtimin e numrit të personelit mësimor në arsimin parashkollor (edukatorë) në buxhetin e miratuar për vitin 2020, si pjesë e raportit 4-mujor të monitorimit të zbatimit të buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.
92. Në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku zhvillohet veprimtaria minerare. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Renta minerare e mbledhur për periudhën tatimore dhjetor 2019, të cilën drejtoritë rajonale të tatimeve/degët e doganave e raportojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në vitin 2020, të llogaritet si rentë për vitin 2020, kurse renta që do të mblidhet për periudhën tatimore dhjetor 2020, të llogaritet si rentë për vitin 2021. Procedura më të detajuara mbi rentën minerare janë të përcaktuara në Udhëzimin e ministrit të Financave nr. 26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.
93. Për llogaritjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohen në ligjin nr. 9632, datë 30.01.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, si dhe ligjin nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
94. Bashkitë kanë kompetencë të plotë për të siguruar ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, në komunitetin e tyre, me përjashtim të shkollave profesionale. Fondet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e ambienteve të arsimit parauniversitar janë të përfshira në burimet e veta vendore. Çdo bashki vendos nivelin e financimit që ajo akordon për këtë funksion nga të gjitha burimet e disponueshme në buxhetin e tyre. Shpenzimet e lidhura me funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të arsimit parauniversitar miratohen si pjesë e buxhetit të çdo bashkie.

95. Të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore të marrin masat e nevojshme për zbatimin e kërkesës ligjore, për njoftimin paraprak të detyrimit tatimor të miratuar me Vendim të Këshillit Vendor, për të gjithë tatimpaguesit (tatimpaguesit familjarë dhe bizneset), në territorin përkatës. Baza e taksave dhe tarifave, si dhe niveli i tyre, çdo përjashtim apo ulje, afati i pagesave, si dhe gjobat e kamatëvonesat e aplikueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi, botohen dhe bëhen të njohura publikisht.
96. Fondi rezervë përdoret sipas kritereve të përcaktuara në aneksin 2 të ligjit nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas kritereve të këtij aneksi i drejtohen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë vlerëson kërkesën e tyre. Nëse fondi rezervë nuk përdoret brenda vitit 2020, ai trashëgohet si transfertë e pakushtëzuar për vitin 2021.
97. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, pas rakordimeve me degën përkatëse të thesarit për fondet e papërdorura në vitin 2019 (nga granti i qeverisjes qendore, në kap.1 “Çelje nga buxheti”, nga të ardhurat e krijuara nga kryerja e veprimtarisë së tyre, në kap.5 ”Të ardhurat e veta”, nga të ardhurat e krijuara në zbatim të legjislacionit specifik, në kap.6 “Të ardhura jashtë limitit”), të cilat trashëgohen në buxhetin e vitit 2020, dërgojnë brenda muajit Janar një kopje të akt-rakordimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
98. Fondet e papërdorura nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transfertat e pakushtëzuar sektoriale gjatë vitit 2020, trashëgohen në buxhetin e vitit 2021 .
99. Brenda muajit Janar, struktura përgjegjëse për borxhin paraqet tek struktura përgjegjëse për buxhetin, planifikimin e disbursimeve të kredisë, të shlyerjes së borxhit dhe fondeve garant të tij në zbatim të marrëveshjeve të huamarrjes vendore për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore sipas raportimeve të bëra nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.
100. Brenda muajit Shkurt 2020, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të kenë përfunduar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë raportin vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për vitin 2019.
101. Për vitin 2020, nëpunësit autorizues të njërive të vetëqeverisjes vendore i paraqesin këshillit përkatës, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuara për çdo program buxhetor të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm. Një kopje e tyre dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
102. Raportet periodike të monitorimit gjatë vitit 2020, që njësitë e vetëqeverisjes vendore do të paraqesin në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, duhet të plotësohen sipas përcaktimeve të udhëzimit standard të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore”.

Detyrimet e prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore

103. Detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të konstatuara dhe të papaguara ndaj të tretëve, të gjitha llojet e detyrimeve financiare, të cilat nuk janë paguar brenda afateve të përcaktuara në ligj; në marrëveshjet kontraktore respektive; në vendimet e gjykatave të formës së prerë, që mbeten të papaguara 60 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e vetëqeverisjes vendore (si dhe kontratat e financuara nga qeveria qendrore).
104. Në buxhetin vendor të vitit 2020, duhet të përfshihet edhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura të akumuluar në vite. Plani i shlyerjes së këtyre detyrimeve duhet të jetë jo më i ulët sesa shuma e raportuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me shkresë zyrtare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
105. Menaxhimi i procesit të shlyerjes së detyrimeve financiare të prapambetura kryhet në mënyrë transparente dhe vetëm pas verifikimit të secilit detyrim financiar të prapambetur.
106. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara që jo më vonë se data 10 Prill 2020 për tremujorin e parë, 10 Korrik 2020 për tremujorin e dytë, 10 Tetor 2020 për tremujorin e tretë dhe 30 Janar 2021 për tremujorin e katërt, të dërgojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë informacionin me shkrim dhe në rrugë elektronike për detyrimet e prapambetura sipas Shtojcës 5 “Raportimi periodik për detyrimet e prapambetura” bashkëlidhur këtij udhëzimi. Brenda dates 30 janar 2020, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të dërgojnë informacionin e përditësuar për detyrimet e prapambetura sipas Shtojcës 5, për periudhën tetor deri në dhjetor 2019.
107. Ministria e Financave dhe Ekonomisë përgatit dhe monitoron raportin për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe stokun e mbetur të detyrimeve për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një muaji nga përfundimi i afatit të dërgimit të këtij informacioni për çdo tremujor raportimi nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.
108. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të publikojnë në faqen e tyre zyrtare informacionin në lidhje me detyrimet e prapambetura.
109. Informacioni financiar për pagesat e detyrimeve të prapambetura do të përditësohet çdo tremujor dhe do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ky raport do të përfshijë gjendjen fillestare të detyrimeve të verifikuara, shlyerjet e kryera gjatë periudhës dhe stokun e mbetur të detyrimeve për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore.
110. Njësitë e vetëqeverisjes vendore për menaxhimin e rasteve të vështirësive financiare duhet të zbatojnë procedurat e përcaktuara në udhëzimin nr.26 datë 27.09.2019 “Për procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

Arkëtimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

111. Me implementimin e sistemit të ri informatik tatimor dhe me mbylljen e llogarive bankare në emër të drejtorive rajonale tatimore, kërkohet çdo ditë të sigurohet dërgimi elektronik në SIFQ i arkëtimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga struktura përgjegjëse për tatimet, sipas klasifikimit ekonomik buxhetor.
112. Njësitë shpenzuese të qeverisjes qendrore dhe vendore të kryejnë pagesën e pagave të punonjësve pas shkarkimit të deklaratës për detyrimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të paraqesin njëkohësisht në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë urdhër shpenzimin për pagesën e pagave dhe urdhër shpenzimin për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe tatimi mbi të ardhurat personale (në këtë proces të konsiderojnë kohën e nevojshme për celjen e numrave seriale të rinj në sistemin C@TS dhe ngarkimin e tyre në SIFQ nga D.P.Tatimeve).
113. Struktura përgjegjëse për Thesarin në degë nuk autorizon pagesën e pagës nëse nuk është paraqitur njëkohësisht edhe pagesa për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe tatimi mbi të ardhurat personale nga njësitë shpenzuese e qeverisjes qendrore dhe vendore.

III. Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes qendrore

114. Detyrime të prapambetura në njësitë e qeverisjes qendrore konsiderohen detyrimet e përcaktuara nga një ligj/kontratë/marrëveshje/vendim gjykate i formës së prerë, që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e qeverisjes qendrore.
115. Brenda datës 10 të çdo muaji pasardhës (i.e: muajit të katërt, të shtatë, të dhjetë dhe muajit janar të vitit pasardhës) njësitë e qeverisjes qendrore raportojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi detyrimet e prapambetura, periodikisht mbi bazë tremujore si dhe sa herë që kërkohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, lidhur me periudha të caktuara apo specifika eventuale. Ky informacion dërgohet me shkrim dhe në rrugë elektronike sipas Shtojcës 3 “Raportimi periodik i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes qendrore”, Shtojcës 4 “Detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për rimbursimin e TVSH”, dhe Shtojcës 3/1 “Skeduli i pagesave të detyrimeve të prapambetura”, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
116. Bazuar në këtë informacion, njësitë përkatëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë proceson të dhënat e marra nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe përgatit raportin e konsoliduar të monitorimit në baza tremujore, brenda një muaji nga përfundimi i afatit të dërgimit të këtij informacioni nga njësitë e qeverisjes qendrore.

i.

117. Raporti i konsoliduar për detyrimet e prapambetura publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

IV. Raportimi i ecurisë së pagesave të koncesioneve/PPP

118. Në zbatim të ligjit nr. 57, datë 2.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. nenit 4/2, Ministria e Financave vlerëson dhe miraton, paraprakisht, të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

119. Autoritetet Kontraktore raportojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, lidhur me ecurinë dhe performancën financiare dhe jofinanciare (arritja e treguesve/outputeve) të secilës prej kontratave koncesionare të tyre. Ky informacion dërgohet me shkrim dhe në rrugë elektronike përkatësisht pranë:

- **Njesisë përgjegjëse për monitorimin e risqeve buxhetore, si vijon:**

- **Brenda datës 5** të muajit pasardhës, dërgohet raportimi sipas Shtojcës 8/1 “*Raportimi periodik mujor i kontratave të koncesioneve/PPP me mbështetje buxhetore*”, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Si edhe, sa herë që kërkohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë lidhur me periudha të caktuara apo specifika eventuale.

- **Drejtorisë përgjegjëse për koncesionet/PPP, si vijon:**

- **Brenda datës 10** të muajit pasardhës të periudhës tre-mujore në monitorim, dërgohet raportimi sipas:
 - o Shtojcës 8/2 “Ecuria e termave të kontratës për të gjitha kontratat koncesionare/PPP”. bashkëlidhur këtij udhëzimi. Si edhe, sa herë që kërkohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë lidhur me periudha të caktuara apo specifika eventuale.
 - o Shtojcës 8/3 “Monitorimi periodik i risqeve për të gjitha kontratat koncesionare/PPP”. bashkëlidhur këtij udhëzimi. Si edhe, sa herë që kërkohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë lidhur me periudha të caktuara apo specifika eventuale.

Bazuar në këtë informacion, drejtorja përgjegjëse për koncesionet/PPP në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë koordinon punën me Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO). Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor dhe Sektorin e Monitorimit të Risqeve Buxhetore dhe përgatit raportin e konsoliduar vjetor të vitit parardhës mbi ecurinë e kontratave aktive të koncesionit/PPP dhe e paraqet për informacion tek Ministri i Financave dhe Ekonomisë. Ky raport përcillet pranë drejtorisë përgjegjëse për menaxhimin e buxhetit, **brenda datës 10 Maj** të çdo viti buxhetor, dhe bëhet pjesë e Raportit të Konsoliduar të Zbatimit të Buxhetit të vitit paraardhës (Buxheti Faktik).

- **Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), si vijon:**
 - **Me fillimin e çdo viti buxhetor**, por jo më vonë se data 10 Gusht, të gjitha autoritetet kontraktore dërgojnë pranë ATRAKOS, kontratat koncesionare/PPP të lidhura prej tyre, me dhe pa mbështetje buxhetore.
 - **Brenda datës 10 Shtator**, ATRAKO përgatit dhe përcjell pranë njësisë përgjegjëse për monitorimin e risqeve buxhetore në drejtorinë e përgjithshme të buxhetit, regjistrin e përditësuar të koncesioneve, me dhe pa mbështetje buxhetore.

V. Monitorimi i ndërmarrjeve shtetërore

120. Në zbatim të ligjit nr. 57, datë 2.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, nenit 4/2, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dorëzohen Planet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare mbi bazë tremujori, të çdo njësie jo të qeverisjes së përgjithshme.
121. Brenda muajit pasardhës të çdo tremujori (i.e: muajit të katërt, të shtatë, të dhjetë dhe muajit janar të vitit pasardhës), ndërmarrjet shtetërore raportojnë pranë njësisë përgjegjëse për monitorimin e risqeve buxhetore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, periodikisht mbi bazë tremujore si edhe sa herë që kërkohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë lidhur me periudha të caktuara apo specifika eventuale. Ky informacion dërgohet me shkrim dhe në rrugë elektronike si vijon:
- Ndërmarrjet shtetërore të sektorit të energjisë (KESH, OSHEE dhe OST) dërgojnë pasqyratfinanciare (bilancin kontabël, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyrën e flukseve të parasë).
 - Ndërmarrjet e tjera shtetërore të pa përfshira në paragrafin më sipër, dërgojnë raportimin sipas shtojcës 9 “Të dhënat financiare kryesore”.
122. Bazuar në këtë informacion, njësia përgjegjëse për monitorimin e risqeve buxhetore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë grumbullon të dhënat e marra nga ndërmarrjet shtetërore dhe përgatit raportin periodik të konsoliduar të monitorimit të ndërmarrjeve shtetërore, brenda një muaji nga përfundimi i afatit të dërgimit të këtij informacioni nga ndërmarrjet shtetërore dhe e paraqet për informacion tek ministri i Financave dhe Ekonomisë.
123. Brenda muajit Shkurt të çdo viti buxhetor njësia përgjegjëse për monitorimin e risqeve buxhetore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë përgatit raportin përmbledhës të konsoliduar të performancës vjetore të ndërmarrjeve shtetërore dhe e paraqet për informacion tek ministri i Financave dhe Ekonomisë.

VI. Monitorimi

124. Raporti i monitorimit për vitin 2019, si edhe raportet periodike gjatë vitit 2020, që ministritë dhe institucionet do të paraqesin në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, duhet të plotësohen në përputhje me Udhëzimin nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, duke iu referuar përcaktimeve në paragrafin 49 të tij, ku midis të tjerave sjellim në vëmendje raportimin lidhur me ecurinë e realizimit të qëllimeve dhe objektivave të politikës që trajtojnë çështjen e barazisë gjinore nëpërmjet treguesve të performancës përkatës duke përfshirë edhe produktet me bazë gjinore të planifikuar në dokumentin e programit Buxhetor Afatmesëm si dhe çdo problematikë të rezultuar duke specifikuar dhe masat e nevojshme për adresimin e tyre.
125. Raporti i monitorimit për vitin 2019 nga ana e njërive të qeverisjes qendrore do të paraqitet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë brenda muajit shkurt 2020.
126. Për fondet speciale: Një kopje e raportit vjetor e miratuar nga Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Këshilli Administrativ i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, paraqitet në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit.

VII. Përcaktime të fundit

127. Pjesë integrale e këtij Udhëzimi janë formatet e zbatimit të buxhetit, bashkëlidhur si më poshtë:
- a. Tabela 1 “Fondi i veçantë limit për vitin 2019”;
 - b. Tabela 2 “Shpenzimet kapitale për Sistemet e IT”;
 - c. Shtojca 1 “Formati i detajimit të fondeve buxhetore”;
 - d. Shtojca 2 “Formati i rishpërndarjes të fondeve buxhetore”;
 - e. Shtojca 3 “Raportimi periodik i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes qendrore”;
 - f. Shtojcës 3/1 “Skeduli i pagesave të detyrimeve të prapambetura”;
 - g. Shtojca 4 “Detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për rimbursimin e TVSH”;
 - h. Shtojca 5 “Raportimi periodik për detyrimet e prapambetura”, për njësitë e vetëqeverisjes vendore”;
 - i. Shtojca 6 “Raportimi i fondit të pagave dhe numrit të punonjësve të njësisë së vetëqeverisjes vendore”;
 - j. Shtojca 7 “Shkresa e njërive të vetëqeverisjes vendore për hapje llogari bankare huamarrjeje”;
 - k. Shtojca 8/1 “Raportimi periodik mujor i kontratave të koncesioneve/PPP me mbështetje buxhetore”;
 - l. Shtojcës 8/2 “Ecuria e termave të kontratës për të gjitha kontratat koncesionare/PPP”;
 - m. Shtojca 8/3 “Monitorimi periodik i risqeve për të gjitha kontratat koncesionare/PPP”;
 - n. Shtojca 9 “Të dhënat financiare kryesore të ndermarrjeve shtetërore”.
128. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij përfundojnë më 31 Dhjetor 2020.



Tabela 1 Fondi i vecante per vitin 2020		ne leke
Kod min	Emertimi i Ministrise / Institucionit Buxhetor	Fondi i vecante viti 2020
1	Presidenca	300,000
2	Kuvendi	500,000
3	Kryeministria	400,000
5	Ministria e Bujqesise	5,800,000
6	Ministria e Infrastruktures /Energjise	3,500,000
10	Ministria e Financave dhe Ekonomise	14,000,000
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	55,000,000
12	Ministria e Kulturës	3,500,000
13	Ministria e Shendetesise	10,000,000
14	Ministria e Drejtesise	10,000,000
15	Minister Punet e Jashtme	1,000,000
16	Ministria e Brendshme	37,000,000
17	Ministria e Mbrojtjes	37,000,000
18	Sherbimi Informativ Shteteror	5,000,000
20	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	400,000
22	Akademia e Shkencës	130,000
24	Kontrolli Larte i Shtetit	600,000
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1,700,000
28	Prokuroria e Pergjithshme	2,800,000
29	Keshilli i Larte Gjygesor	4,500,000
30	Gjykata Kushtetuese	150,000
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	150,000
35	Keshilli i Larte i Prokurorise	150,000
41	SPAK/Byro hetimi	120,000
50	Instituti Statistikës	500,000
55	Shkolla e Magjistratures	150,000
57	Qendra Kombetare e Kinematografise	100,000
63	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	150,000
63	Kolegji i Posacem i Apelit	150,000
63	Komisioneri Publik	150,000
63	Inspektoriati Larte i Drejtesise	150,000
66	Avokati i Popullit	150,000
67	Komisioneri per Mbikqyrjen e Sherbimit Civil	100,000
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	250,000
76	Inspektoriati i Larte i Deklarimit e Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesave	150,000
77	Autoriteti i Konkurences	200,000
82	Keshilli Kombetar i Kontabilitetit	100,000
87	Institucione te tjera Qeveritare	3,200,000
	<i>Drejtoria Sigurimit te Informacionit Klasifikuar (DSIK)</i>	100,000
	<i>Agjensia e Prokurimit Publik</i>	100,000
	<i>Komiteti per Pakicat Kombetare</i>	100,000
	<i>Inspektoriati Qendror</i>	100,000
	<i>Agjensia e Menaxhimit te Burimeve Ujore</i>	250,000
	<i>Qendra kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit</i>	100,000
	<i>Agjensia për Diasporën</i>	100,000
	<i>Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët</i>	100,000
	<i>Qendra Botimeve të Diasporës</i>	100,000
	<i>Agjensia për Hapje, Dialog dhe Bashkeqeverisje</i>	100,000
	<i>Agjensia e Zhvillimit te Territorit</i>	100,000
	<i>Agjensia Kombetare e Planifikimit te Territorit</i>	100,000
	<i>Agjensia Autonome e Auditimit te Fondeve te BE</i>	150,000
	<i>Agjensia Kombetare e Shoqerise se Informacionit</i>	500,000
	<i>Agjensia Ofrimit te Sherbimeve Publike (ADISA)</i>	300,000
	<i>Komiteti Shteteror i Kulteve</i>	100,000
	<i>Departamenti i Administrates Publike</i>	100,000
	<i>Shkolla Shqiptare e Administrates Publike</i>	100,000
	<i>Autoriteti Komb. Cert. Elektrikiber (ACESK)</i>	100,000
	<i>Sekretariati Teknik i KEK</i>	100,000
	<i>Autoriteti Shteteror Gjeohapsinor (ASIG)</i>	100,000
	<i>Avokatura e Shtetit</i>	300,000
88	Mbeshtetje per shogerine civile	100,000
	Komisioneri per te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e te Dhenave	
89	Personale	200,000
90	Komisioni i Prokurimit Publik	150,000
91	Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi	150,000
92	Instituti i studimeve te krimeve te komunizmit	100,000
95	Autoriteti Drejten e Informimit per Dokumentet ish-sigurimit	100,000
	TOTALI	200,000,000

TABELA 2 - SHPENZIMET KAPITALE PER SISTEMET IT

000/LEK

MINISTRIA E LINJES / INSTITUCIONI PERITUES	EMERTIMI I PROJEKTIT	Vlera
TOTALI		373,454
KRYEMINISTRIA	Zgjerimi i sistemit egzistues te sigurise ne katin nenetoke te Kryeministrise	35,954
Ministria e Arsimit dhe Sportit	Permiresimi i sistemit te provimit te shtetit per profesionet e rregulluara	50,000
Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	F.V modul I ankimit dhe modul I vleresimit ne kuader te projektit per modernizimin e asistences sociale	50,000
Ministria e Drejtesise	Blerje pajisjesh "Skaner Bagazhesh per institucionet e sigurise se larte, te gjitha IEVP-te e Sigurise se Larte ne Drejtorine e Burgjeve si dhe AKSHIT"	102,000
	Ngritja e regjistrimit elektronik te ekspertve	50,000
inspektoriat Qendror	Pajisje hardware per sistemimin online te inspekimit (blerje tableta per inspektimin online, infrastrukture servera)	15,753
	Mirëmbajtje e portalit e-inspection	39,747
Ministria e Financave dhe Ekonomise	Ngritje e Sistemit, kryerja e shërbimit të risk assesment dhe data loss prevention per DPD	30,000

Shtojca Nr.1: Formati i Detajimit te fondeve buxhetore 2019 per Njesine e Qeverisjes _____

Shembulli: AUTORITETI KONKURRENCES

Entiteti i Qeverisjes	Ministria	Kod Institucioni	Emer Institucioni	Kapitull	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi Deges Thesarit	Kodi i produktit	Emertimi Produktit	Shuma ne lekë
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencws	01	04120	6000000	3535	97701AA	Marreveshjet e ndaluara , abuzimi me poziten dominuese dhe perqendrimet	53,000,000
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencws	01	01110	6010000	3535	97701AA	Marreveshjet e ndaluara , abuzimi me poziten dominuese dhe perqendrimet	8,500,000
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencws	01	01110	6020000	3535	97701AA	Marreveshjet e ndaluara , abuzimi me poziten dominuese dhe perqendrimet	10,260,000
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencws	01	01110	6060000	3535	97701AA	Marreveshjet e ndaluara , abuzimi me poziten dominuese dhe perqendrimet	240,000
TOTALI										72,000,000

Entiteti i Qeverisjes	Ministria e Linjes	Kodi Institucioni	Emer institucioni	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i Deges se Thesarit	KOD Produkti	Emertimi i produktit	Debiti
			Pakesohet							
001	12	1012060	Instituti i Monumenteve te Kulture	01	08220	6000000	3535	91202AA	Objekte monument kulture te ruajtura dhe mbrojtura	400.000
001	12	1012060	Instituti i Monumenteve te Kulture	01	08220	6010000	3535	91202AA	Objekte monument kulture te ruajtura dhe mbrojtura	150.000
			Shtohet							
001	12	1012014	Qendra Muzeumeve Berat	01	08220	6020000	0202	91202AC	Muze te mirembajtura dhe te vizitueshem nga publiku	550.000

Skeduli i pagesave të detyrimeve të prapambetura për vitin 2019

në mijë lekë

Periudha / Kategoria	Pagesa të planifikuara për periudhën Janar-Mars	Pagesa të planifikuara për periudhën Prill-Qershor	Pagesa të planifikuara për periudhën Korrik-Shtator	Pagesa të planifikuara për periudhën Tetor-Dhjetor
Detyrime Kapitale				
Detyrime Korrente				
Detyrime të prapambetura për vendime Gjyqësore				
Detyrime Totale				

Shtojca 5 "Raportimi periodik për detyrimet e prapambetura"

Bashkia

Detyrimet e (Detalja dhe) (1)	Viti 2020				(8)	Viti 2020			(12)	(13=7+11+12)	(14=13/7*100)
	(3)	(4)	(5)	(6)		(9)	(10)	(11)			
Detyrimet e mbetur deri në 31.12.2015	Detyrimet i kusur Viti 2016, 2017, 2018, 2019	Detyrimet e krijuara nga 1 Janar - 31 Mars 2020	Detyrimet e krijuara nga 1 Prill - 31 Qershor 2020	Detyrimet e krijuara nga 1 Korrik - 30 Dhjetor 2020	Detyrimet e prapambetura të shëna Viti 2015, 2016, 2017, 2018, 2019	Detyrimet e krijuara nga 1 Janar - 31 Mars 2020	Detyrimet e shëna nga 1 Prill - 31 Qershor 2020	Detyrimet e shëna nga 1 Korrik - 30 Dhjetor 2020	Totali i detyrimeve të shëna	#DIV/0!	#DIV/0!
Vlera Totale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0
Investimet TVSH dhe Kosto lokale					0				0	#DIV/0!	0
Mallra dhe Shërbime					0				0	#DIV/0!	0
Vendime Gjyqësore					0				0	#DIV/0!	0
Të tjera					0				0	#DIV/0!	0

Shtënim: Në tabelën 1 duhet të pasqyrohen vlerat e detyrimeve të krijuara rritëse dhe të shlyera për tremujorin e katërt, krahas vlerave për detyrimet e krijuara dhe të shlyera në vitet e mëparshme. Në zërin "investime" nuk duhet të përfshihen investimet e financuara nga FZHR, pasi këto detyrime duhet të evidentohen në vetë në tabelën nr. 2.

Tabela nr. 2: Raporti përmbledhës për detyrimet e mbetura nga investimet financiarë nga FZHR për tremujorin

Emertimi i projektit	Mësimi i Llogaritjes	Kodi i Projektit	Viti i financimit të projektit	Vlera e financuar		Vlera e financuar		Vlera e financuar		Detyrimet	
				deri në vitin 2015	ne vitin 2016	ne vitin 2017	ne vitin 2018	ne vitin 2019	ne vitin 2020	mbetur për financim	mbetur
Vlera Totale			0	0	0	0	0	0	0	0	0

Shtënim: Në tabelën nr. 2, në kolonën "Viti i financimit të projektit" duhet të shënohet viti i kusur i kontratës së financimit të projektit

Tabela nr. 3: Raporti përmbledhës për detyrimet e prapambetura të SHLYERA (për detyrimet e prapambetura të krijuara deri në vitin 2015)

Detyrimet e shlyera për detyrimet e prapambetura të krijuara deri në 31.12.2015	Detyrimet e shlyera për detyrimet e prapambetura të krijuara deri në 31.12.2015
Vlera Totale	0
Investimet	
Investimet nga TVSH dhe Kosto lokale	
Mallra dhe Shërbime	
Vendime Gjyqësore	
Të tjera	

Shtënim: Tabela nr. 3 duhet të plotësohet me sfera progresive për detyrimet që janë shlyer nga detyrimet e krijuara deri në vitin 2015. Shlyerja e plotë e këtyre detyrimeve duhet të shënohet në këtë tabelë dhe të jetë e barabartë me sferat e shlyerësve të tjera.

Shënimet të tjera:
Çdo qelizë me ngjyrë blu është me formulë, ndërsa të tjerat duhet plotësuar manualisht.

Shtojca Nr. 6

Raportimi i Fondit te pagave dhe Numrit te punonjesve te njesise se qeverisjes vendore

Emri i njesise	Viti 2009 (fakti)		Viti 2010	
	Numri i punonjesve	Fondi i pagave (ne leke)	Numri i punonjesve	Fondi i pagave (ne leke)
Administrata e njesise	0.0	0.0	0.0	0.0
Punonjes me kontrate (Administrata)	0.0	0.0	0.0	0.0
Institucionet e varesise	0.0	0.0	0.0	0.0
Punonjes me kontrate (Institucionet e varesise)	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali	0.0	0.0	0.0	0.0

Shtojca Nr. 7 "Shkresa e Njesive Vendore per Hapje Llogarie Huamarrjeje"



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PERGJITHSHEME E THESARIT
DREJTORIA OPERACIONALE

Nr. 2317 Prot.

Tirane, më 22.02.2010

Per: **BANKA KOMBETARE TREGTARE**

Per njoftim: Dega e Thesarit Elbasan
Bashkia Elbasan


Subjekti: Kerkese per hapje llogarie

Ne zbatim te Ligjit Nr.9860, dt.04.02.2008 "Per Huamarrjen e Qeverisjes Vendore" si dhe Lidhezimit te Ministrise se Financave Nr.35, dt. 05.04.2008 "Per Huamarrjen e Qeverisjes Vendore", lutemi te hapni prane Bankes Kombetare Tregtare Dega Elbasan, llogarine tranzite per Huamarrjen e Qeverisjes Vendore: "Dega e Thesarit Elbasan-Huamarrje Njesia Vendore" ne LEKB.

Kja llogari du te funksionojte ne perputhje me Akt-Marrveshjen midis Ministrise se Financave dhe Bankes tuaj.

Pas hapjes se kesaj llogarie, lutemi njoftoni numrin e saj IBAN prane Dages se Thesarit Elbasan dhe Ministrise se Financave - Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit - Drejtoria Operacionale.

Ridvan BODE



Raportimi periodik mujor i kontratave të koncesioneve/PPP me mbështetje buxhetore

Pagesa buxhetore në mijë Lekë		Pagesa faktike / Planifikuar																				
Autoriteti Kontraktor	Nr	Emërimi i Kontratës PPP	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Programi	Artikulli	Plan Total 2019	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dijetor	Total	Arsy e rejalimit apo mosrealizimit	
Ministria ...	1																					
	2																					
	3																					
	TOTALI																					

Treguesit e performancës																					
Autoriteti Kontraktor	Nr	Emërimi i Kontratës PPP	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dijetor	Total	Arsy e rejalimit apo mosrealizimit					
Ministria ...	1	Treguesi i performancës*	Treguesi 1																		
			Treguesi 2																		
			Treguesi 3																		
Ministria ...	2	Treguesi i performancës*	Treguesi 1																		
			Treguesi 2																		
			Treguesi 3																		

* Treguesit e performancës mund të jenë më shumë se një, dhe ndryshojnë nga tipologjia e kontratës së koncesionit/PPP-ve

Ekipa e kontratit të kontratës për të gjitha kontratat koncesionare/PPP									
Emërtimi i Kontratës	Kohezia e kontratës		Data e fillimit të kontratës		Komentet në rast mosrealizimi apo tejkalimi	Viti t+1	Viti t+2	Viti n	
	Emërtimi i SPV	Investimi i parashikuar	3-mujori I	3-mujori II					
Pagesat buxhetare progresive (mijë lekë)	Planifikuar								
	Faktike								
	Planifikuar								
Shpenzimet Kapitale(Investimi)	Faktike								
	Planifikuar								
	Faktike								
Deklarimi i nivelit vjetor të minimumit të garantuar të kërkesës të përçaktuar në kontratë. Kjo vlen vetëm për kontratat që bazohen në nivelin e kërkesës	Planifikuar								
	Faktike								
	Planifikuar								
Niveli i kërkesës	Faktike								
	Planifikuar								
	Faktike								
Niveli i të ardhurave	Planifikuar								
	Faktike								
	Planifikuar								
Norma e brendshme e këthimit	Planifikuar								
	Faktike								
	Planifikuar								
Detyrimet Kontingjente	Planifikuar								
	Faktike								
	Planifikuar								
Indikator Kryesor i Performancës 1	Objektivi								
	Realizimi								
	Planifikuar								
Indikator Kryesor i Performancës n	Objektivi								
	Realizimi								
	Planifikuar								
Indikator Kryesor i Performancës 1	Objektivi								
	Realizimi								
	Planifikuar								
Indikator Kryesor i Performancës n	Objektivi								
	Realizimi								
	Planifikuar								
Viti 2019									
Deklarim i rasteve të mospermbushjes së detyrimeve kontraktore	Kategoria	Penalitet e aplikuar		Masa e ndërmarrë		Detyrim i Shlyer		Po/Jo	
	Raportim mbi mospermbushjet nga Autoriteti Kontraktues								
	Raportim mbi mospermbushjet nga Koncessionarin								

Monitorimi periodik i risqeve për të gjitha kontratat koncesionare/PPP

Emërtimi i Kontratës	Kohezgjatja e kontratës		Data e fillimit të kontratës					
	Emërtimi i SPV	Investimi i parashikuar	Data efektive e kontratës	Realizimi				
Perashkrimi	Risikimi (Koncesionari/Auto Risikimi)	Risikimi (Koncesionari/Auto Kontraktues)	Materializuar (EUREP)	Materializuar (EUREP)	Impakti i Risikut i Realizuar	Mbështetja e Siguruar (në rast të sigurve) (EUREP)	Probabiliteti	Impakti
Rreziku i qeverisjes								
Rreziku i ndërtimit								
Rreziku i kërkesës								
Rreziku i Operimit dhe performancës								
Rreziku financiar								
Forca madhore								
Rreziku material nga vendimet politike								
Rreziku i ndryshimeve ligjore								
Rreziku i ribalancimit të ekuilibrit financiar								
Rreziku i rinegocimit								
Ndërprejta e kontratës								

* Probabiliteti dhe Impakti i parashikuar vlerësohen si : i ulët/i mesëm/i i lartë

Shtojca 9

Të dhënat financiare kryesore (në mijë lekë)				
Perioda	Bilanc (X-1)	3 mujori (X)	Parashikimi vjetor (X)	Parashikimi Vjetor (X+1)
Të ardhurat				
Shpenzimet				
Humbje/Fitim				
Aktivët korrente				
Aktivët fikse				
Investimet bruto				
Aktive				
Detyrimet afatshkurtra				
Detyrimet afatgjata				
Detyrimet				
Pasuria Neto				

Shifrat duhet të konsolidohen duke eliminuar transaksionet e brendshme dhe borxhet.

Shifrat e investimeve bruto do të jetë informacion i dobishëm shtesë.